



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE

Nr. 54/6 prot.

Tiranë më, 28.07.2023

V E N D I M

Nr. 2 Datë 28.07.2023

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

Erjana Pjetri	Kryesuese
Ersa Karaj	Relatore
Klevis Dhigoi	Anëtar

më datë 28.08.2023, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket subjektit:

SUBJEKTI I VLERËSIMIT: **Z. Oltian Dervish Bistri**, me funksion aktual Specialist për Krimet në Volum, në Drejtorinë për Krimet në Volum, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit; ish-Drejtor, Drejtorja e Forcës së Posaçme Operacionale, Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

BAZA LIGJORE: **Ligji nr. 12/2018** “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar.

Udhëzimi Nr.7 datë 17.01.2023 i Ministrit të Brendshëm “Për procedurat dhe mënyrat e hedhjes së shortit për trupat e vlerësimit dhe subjektet e vlerësimit të ligjit 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar”.

Rregullore Nr. 197, datë 28.02.2023 “Për hapat proceduralë të unifikuar”.

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore është organi kompetent që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, bazuar në Ligjin nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.
2. Neni 6, pika 1, shkronjat (a), (b), (c), (ç) dhe (d) të Ligjit Nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” i ndryshuar, përcakton fushën e ushtrimit të veprimtarisë së Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, duke përcaktuar rrethin e subjekteve, që i nënshtrohen procesit të vlerësimit kalimtar nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore.
3. Në zbatim të nenit 6 të ligjit Nr. 12/2018 i ndryshuar, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore vlerëson punonjësit në pozicionet e mëposhtme:
 - a) *drejtor dhe zëvendësdrejtor i përgjithshëm, drejtor departamenti, drejtor i Drejtorisë Qendrore, drejtor në strukturat e veçanta, drejtor e zëvendësdrejtor vendor, drejtor në drejtoritë e kufirit dhe migracionit, shef komisariati, shef sektori në nivel qendror e vendor, që mbulon fushën e krimit të organizuar, krimit ekonomik/financiar dhe policisë rrugore në Policinë e Shtetit;*
 - b) *drejtor dhe zëvendësdrejtor i përgjithshëm, drejtor drejtorie dhe shef njësie në Gardën e Republikës;*
 - c) *drejtor dhe zëvendësdrejtor i përgjithshëm, drejtor drejtorie, shef sektori në nivel qendror dhe vendor në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore;*
 - ç) *punonjësit që do të emërohen në strukturën e vlerësimit kalimtar/periodik në AMP;*
 - d) *çdo punonjës që emërohet në pozicionet e përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç”.*
4. Z. Oltian Dervish Bistri, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit Nr.12/2018, i ndryshuar, ka ushtruar funksionin e Drejtorit, në Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Për këtë arsye, si subjekt i këtij ligji, i është nënshtruar procedurës së shortimit më datë 04.07.2023, nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, në përputhje me Udhëzimin Nr.7 datë 17.01.2023 të Ministrit të Brendshëm “Për procedurat dhe mënyrat e hedhjes së shortit për trupat e vlerësimit dhe subjektet e vlerësimit të ligjit 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar”.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me shkresën Nr. *** prot., datë 07.07.2023, ka depozituar pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore formularët për subjektet e shortuar më datë 04.07.2023, ku rezulton të jenë depozituar formularët e deklarimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe aftësive profesionale të subjektit të vlerësimit Z. Oltian Bistri, të cilat janë marrë në dorëzim nga relatorja e çështjes.
6. Policia e Shtetit, në zbatim të nenit 3 të Udhëzimit Nr.7 datë 17.01.2023 të Ministrit të Brendshëm “*Për procedurat dhe mënyrat e hedhjes së shortit për trupat e vlerësimit dhe subjektet e vlerësimit të ligjit 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar*”, ka detyrimin ligjor të njoftojë me shkrim Agjencinë për çdo ndryshim strukturor apo lëvizje të personelit, brenda pozicioneve të përcaktuara në nenin 6 të ligjit Nr.12/2018, i ndryshuar. Për këtë arsye, me shkresën Nr. *** prot., datë 24.07.2023 “*Informacion*”, Drejtoria e Burimeve Njerëzore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, informon Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, se me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr.*** prot. datë 20.07.2023 “*Për transferimin dhe emërimin në detyrë të një punonjësi policie*”, Kryekomisar Oltian Dervish Bistri, me detyrë Drejtor, në Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale, në Departamentin e Policisë Kriminale, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, nuk është më subjekt i Vlerësimit Kalimtar dhe Periodik, pasi për nevoja pune, është transferuar dhe emëruar në detyrën Specialist, në Sektorin për Krimet në Volum, në Drejtorinë për Krimet në Volum, në Departamentin për Sigurinë Publike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
7. Trupa e Vlerësimit është vënë në dijeni të transferimit dhe emërimit të Subjektit të Vlerësimit në një pozicion që nuk parashikohet në nenin 6 të ligjit Nr.12/2018, i ndryshuar, në kushtet kur nuk kishte marrë vendim për fillimin e hetimit administrativ për procedurën e vlerësimit kalimtar ndaj subjektit të vlerësimit Z. Oltian Dervish Bistri.

II. ARSYETIMI LIGJOR I TRUPËS SË VLERËSIMIT

8. Trupa e Vlerësimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, administroi edhe dokumentacionin si vijon:
 - Shkresë Nr.*** prot. datë 24.07.2023 “*Informacion*” për Kryekomisar Oltian Dervish Bistri, dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Burimeve Njerëzore.
 - Urdhër i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit me Nr.*** prot. datë 20.07.2023 “*Për transferimin dhe emërimin në detyrë të një punonjësi policie*” të lëshuar nga institucioni përgjegjës, që është Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, të protokolluar nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore me Nr. *** prot. datë 27.07.2023.

- Organika e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
9. Nga verifikimi i akteve, Trupa e Vlerësimit konstaton se ndodhemi në kushtet e transferimit dhe emërimit të subjektit të vlerësimit në detyrën Specialist, në Sektorin për Krimet në Volum, në Drejtorinë për Krimet në Volum, në Departamentin për Sigurinë Publike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë Shtetit, bazuar në ligjin Nr.108/2014 "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, dhe për këtë arsye Z. Oltian Dervish Bistri:
- **Nuk është subjekt i vlerësimit kalimtar dhe periodik, për shkak të pozicionit të tij të punës jashtë fushës së ushtrimit të veprimtarisë së institucionit të vlerësimit kalimtar (Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore); pra pozicion që nuk përcaktohet në pikën 1 të nenit 6 të ligjit Nr. 12/2018, i ndryshuar.**
10. Trupa vlerëson se objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i procesit të vlerësimit kalimtar të subjektit të vlerësimit është ligjërish i pamundur, si edhe përmbushen kushtet e përcaktuara në nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative.
11. Trupa e Vlerësimit, vendos se duhet të ndërpritet procesi i vlerësimit për Z. Oltian Dervish Bistri, bazuar në dokumentacionin e administruar, si dhe në përputhje me nenet 11 dhe 16 të Kodit të Procedurës Administrative.

PËR KËTO ARSYE

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, mbështetur në Ligjin Nr.12/2018 "Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme", i ndryshuar, si dhe në nenet 11, 16 dhe 95 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë;

V E N D O S I:

1. Ndërprerjen e procesit të vlerësimit kalimtar të Z. Oltian Dervish Bistri, me funksion aktual Specialist për Krimet në Volum, në Drejtorinë për Krimet në Volum, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, pa një vendim përfundimtar.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim u njoftohet Z. Oltian Dervish Bistri, si edhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit brenda 15 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.

3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të ligjit Nr. 12/2018, i ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 45 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim u shpall sot në datë 28.07.2023, në Tiranë.

TRUPA E VLERËSIMIT

Erjana PJETRI
Kryesuese

Ersa KARAJ
Relatore

Klevis DHIGOI
Anëtar